

BULETINI INFORMATIV

Gjatë muajit gusht, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka vijuar ushtrimin e përgjegjësi të tij ligjore për rregullimin, monitorimin dhe zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror. Në kuadër të veprimtarisë së Bordit dhe administratës së ERE-së janë ndërmarrë vendimmarrje dhe aktivitete të rëndësishme që lidhen me licencimin e operatorëve, mbikëqyrjen e tregut, përmirësimin e kuadrit rregullator, forcimin e bashkëpunimit institucional dhe rritjen e transparencës për publikun.

Në këtë numër të Buletinit Informativ paraqiten zhvillimet kryesore të veprimtarisë së ERE-së gjatë muajit gusht 2026, duke përfshirë vendimmarrjet e Bordit, procedurat administrative në fushën e licencimit dhe autorizimeve, zhvillimet dhe monitorimin e tregut të energjisë elektrike, proceset rregullatore, si dhe veprimtarinë në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Gjithashtu, në fokus janë edhe aktet dhe masat e ndërmarra për vijimin e përafrimit të kuadrit rregullator me zhvillimet e sektorit dhe standardet evropiane.

Në përmbushje të misionit dhe funksioneve të saj ligjore, ERE vijon angazhimin për garantimin e një kuadri rregullator të qëndrueshëm, të parashikueshëm dhe transparent, duke kontribuar në sigurinë e furnizimit me energji, zhvillimin e konkurrencës dhe integrimin e mëtejshëm të tregut shqiptar të energjisë me tregjet rajonale dhe evropiane.

Për më shumë informacion mbi veprimtarinë e ERE-së, vendimet e Bordit, aktet rregullatore dhe proceset në zhvillim, vizitoni faqen zyrtare të Entit Rregullator të Energjisë: www.ere.gov.al

LICENSIME

Gjatë muajit gusht 2026, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka vijuar procedurat administrative për licencimin e subjekteve të reja dhe për ndryshimin, rinovimin, transferimin e licencave ekzistuese në sektorin e energjisë elektrike, në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.



VENDIME PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT

Në këtë kuadër, ERE ka filluar procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “3X ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 70 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 3268, fshati Savër, Njësia Administrative Lushnjë, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier. Projekti parashikon gjithashtu sisteme të akumulimit të energjisë, për të cilat ERE po vijon vlerësimin në përputhje me kuadrin ligjor dhe kontraktual në fuqi.

Gjithashtu, është miratuar fillimi i procedurës administrative për licencimin e shoqërisë “KRONOS KONSTRUKSION” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 50 MW, me vendndodhje në afërsi të fshatit Vërnik, Njësia Administrative Qendër Bilisht, Bashkia Devoll, Qarku Korçë.

Po gjatë kësaj periudhe, ERE ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë “EUROTECH INNOVATION” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.

Krahas sa më sipër, ERE ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë “ALBPOWER” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

BULETINI INFORMATIV



Vendime për fillimin e procedurave të rinovimit të licencë

Gjatë muajit gusht 2026, Bordi i ERE-s ka vendosur të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "NOA ENERGY TRADE" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat pesëvjeçar.

Për këtë aplikim, në përputhje me "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, ERE ka publikuar njoftimin përkatës në median e shkruar, në faqen zyrtare www.ere.gov.al si dhe në rrjetet sociale [Instagram](#), [Facebook](#) dhe [LinkedIn](#), duke mundësuar paraqitjen e objeksioneve të mundshme përpara vendimmarrjes përfundimtare.



Vendime për zgjatjen e afatit të vendimmarrjes

Gjatë muajit gusht 2026, Bordi i ERE-s, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, ka vendosur të shtyjë/zgjatë me 30 ditë afatin e vendimmarrjes për kërkesat për licencim të shoqërive, si më poshtë:

Këto procedura lidhen me shoqërinë "GERTI" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për plotësimin dhe depozitimin e dokumentacionit të nevojshëm në kuadër të kërkesës për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Gjithashtu, zgjatja e afatit të vendimmarrjes është vendosur për shoqërinë "YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA" sh.p.k., për plotësimin dhe depozitimin e dokumentacionit të nevojshëm për rinovimin e licencave në veprimtaritë e furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Po gjatë kësaj periudhe, Bordi i ERE-s ka vendosur zgjatjen me 30 ditë të afatit të vendimmarrjes për shoqërinë "BUSHTRICA 2017" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Bushtrica 2", me kapacitet të instaluar 4,800 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, Qarku Elbasan.



Vendime për licencim

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, Bordi i ERE-s ka vendosur të licencojë disa shoqëri në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Shoqëria "GLOBAL INTERPRISE GROUP" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Doma", me kapacitet të instaluar 1.695 MW, me vendndodhje në përroin e Lusës, degë e lumit Mat, Bashkia Klos, Qarku Dibër, për një afat 30-vjeçar. Shoqëria duhet të nisë operimin e HEC-it brenda datës 23 janar 2027.

Gjithashtu, është licencuar shoqëria "GERTI" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në Vlashaj, Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër. Shoqëria duhet të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.07.2027.

Po ashtu, ERE ka licencuar shoqërinë "ASSA ENERGY SOLUTIONS" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, për një afat 30-vjeçar.

Vendime për pezullimin e afatit të vendimmarrjes

Në kuadër të administrimit të procedurave në vijim, Bordi i ERE-s ka vendosur të pezullojë afatin e vendimmarrjes për kërkesën e shoqërisë "GreeNNat Solar Park Ballsh" sh.p.k., lidhur me ndryshimin e numrit të paneleve fotovoltaike. Pezullimi i afatit të vendimmarrjes është vendosur deri në marrjen e sqarimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nëse ky ndryshim përbën ndryshim të parametrave teknikë/energjetikë sipas kontratës dhe nëse për këtë ndryshim kërkohet miratim paraprak nga MIE. Afati i pezullimit do të zgjasë jo më shumë se 30 ditë nga njoftimi drejtuar MIE-së.



BULETINI INFORMATIV



Vendime për transferimin e licencave

Në kuadër të procedurave për administrimin dhe transferimin e licencave, Bordi i ERE-s ka vendosur miratimin e transferimit të plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike, të dhënë shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. me vendimin nr. 77, datë 29.04.2024, për HEC “Polemi”, në kuadër të ristrukturimit organizativ dhe financiar të aktivitetit.

Transferimi synon një ndarje më të qartë dhe administrim më efikas të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, si dhe paraqitjen e pasqyrave financiare të veçuara për këtë aktivitet

- ✓ Vendimmarrja u mor pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar dhe marrjes së miratimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- ✓ HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 MW, me vendndodhje në Bashkinë Bulqizë, Qarku Dibër, te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k. është në prodhim që prej muajit korrik të vitit 2024.



Vendime për modifikimin e licencave

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, Bordi i ERE-s ka miratuar modifikimin e licencave të prodhimit të energjisë elektrike për katër shoqëri që operojnë centrale fotovoltaike, duke reflektuar në Aneksin A të licencave përkatëse sistemet e depozitimit të energjisë elektrike të integruara në këto impiante, konkretisht:

1

“POWER ENERGY” sh.p.k. – centrali fotovoltai me fuqi të instaluar 25 MW, në Povelçë, Bashkia Fier, me sistem depozitimi me fuqi 25.075 MW (5×5.015 MW);

“GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. – centrali fotovoltai me fuqi të instaluar 100 MW, në Ballsh, Bashkia Mallakastër, me sistem depozitimi me fuqi 90 MW (36×2.5 MW); Në rastin e shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., kërkesa për modifikimin e licencës përfshinte edhe ndryshimin e numrit të paneleve fotovoltaike. Shqyrtimi i kësaj pjese të kërkesës është pezulluar në pritje të sqarimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), ndërsa Bordi ka vijuar veçmas me shqyrtimin dhe miratimin e pjesës që lidhej me reflektimin në licencë të sistemit të depozitimit të energjisë elektrike.

2

“IDI 2005” sh.p.k. – centrali fotovoltai me fuqi të instaluar 8.8 MW, në Povelçë, Bashkia Fier, me sistem depozitimi me fuqi 50 MW (5×10 MW);

“Sunny Side Energy” sh.p.k. – centrali fotovoltai me fuqi të instaluar 100 MW, në Darzezë, Bashkia Fier, me sistem depozitimi me fuqi 100.3 MW (20×5.015 MW).

Këto modifikime janë miratuar në kuadër të regjimit kalimtar të parashikuar nga ligji nr. 59/2026 për sistemet e depozitimit të energjisë elektrike të integruara në impiantet e prodhimit.

Në të gjitha këto raste, e drejta për operimin e sistemeve të depozitimit të energjisë elektrike brenda licencës është e vlefshme deri në përfundim të periudhës së përcaktuar në nenin 51, pika 5, të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, shoqëritë kanë detyrimin të aplikojnë pranë ERE-s për licencë për operimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike.

Vendime për ndryshimin e vendimeve të mëparshme

Për plotësimin e kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të licencimit, Bordi i ERE-s ka vendosur të ndryshojë vendimin nr. 238, datë 06.11.2016, “Mbi licencimin e shoqërisë “ORHER” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”. Këto ndryshime pasqyrojnë përmbushjen e kushtit të vendosur në vendimin e licencimit, lidhur me depozitimin brenda afatit të dokumentacionit përkatës të testimit të veprës.

BULETINI INFORMATIV



AUTORIZIME MBI ASETET DHE STRUKTURËN E PRONËSISË

Gjatë muajit gusht 2026, Bordi i ERE-s ka shqyrtuar dhe miratuar kërkesat e paraqitura nga subjektet për dhënien e autorizimeve lidhur me transferimin e aseteve dhe barrësimin e kuotave të shoqërive. Këto procedura janë trajtuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, me qëllim garantimin e transparencës dhe respektimin e kërkesave rregullatore që lidhen me ndryshimet në strukturën e pronësisë dhe asetet e subjekteve të licencuara.:

Transferim asetesh

Bordi i ERE-s ka miratuar dhënien e autorizimit për shoqërinë "DRINI BULQIZË" sh.p.k. për transferimin e aseteve të paluajtshme të saj te shoqëria "HEC Polemi" sh.p.k.

Gjithashtu, është miratuar dhënia e autorizimit për shoqërinë "IDI 2005" sh.p.k. për transferimin, nëpërmjet kontratës së hipotekës, të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj "Intesa SanPaolo Bank Albania" sh.a.



Barrësim kuotash

Në lidhje me barrësimin e kuotave, Bordi i ERE-s ka miratuar dhënien e autorizimit për vendosjen e kuotave të shoqërisë "HEC VLUSHE" sh.p.k., si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj palës kredidhënëse "Intesa SanPaolo Bank Albania" sh.a.

Ndryshim ortaku

Bordi i ERE-s miratoi dhënien e autorizimit për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë "NOA ENERGY TRADE" sh.p.k, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Rishikim i vendimit nr. 44/2026

Gjithashtu, janë miratuar disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 44, datë 11.02.2026, lidhur me ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë "PARISOL" sh.p.k. Vendimi i ri pasqyron përmbushjen e kushtit të percaktuar me herët nga ERE, pas marrjes së miratimit nga "Intesa SanPaolo Bank Albania" sh.a. për transferimin e 70% të kuotave të ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërise.

REMIT

Në përputhje me "Rregulloren për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT)", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 17.05.2021, si dhe me Ligjin nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike", ERE ka vijuar procesin e përditësimit dhe administrimit të të dhënave mbi regjistrimin e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike që hyjnë në transaksione me shumicë në Shqipëri, në kuadër të Regjistrit REMIT.

Regjistri REMIT përbën një instrument të rëndësishëm për rritjen e transparencës dhe integritetit të tregut të energjisë elektrike, duke mundësuar identifikimin dhe evidentimin e pjesëmarrësve që kryejnë transaksione me shumicë, si dhe mbështetur proceset e monitorimit dhe mbikëqyrjes së zhvillimeve të tregut nga ERE.

Për muajin gusht 2026, numri total i shoqërive të regjistruara në Regjistrin REMIT është 106. Të dhënat e regjistrit vijnë në përditësohen në mënyrë periodike, në funksion të pasqyrit sa më të plotë dhe transparent të pjesëmarrësve të regjistruar në tregun me shumicë të energjisë elektrike.

Regjistri REMIT është i publikuar dhe i aksesueshëm në faqen zyrtare të ERE-së, në adresën: remit.ere.gov.al.



BULETINI INFORMATIV



ZHVILLIMET NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE – TË DHËNAT PËR MUAJIN KORRIK 2026

Sipas të dhënave të administruara nga ERE për muajin korrik 2026, kapacitetit total prodhues të energjisë elektrike të instaluar në vend iu shtuan dy centrale të reja fotovoltaike. Njëri prej tyre, me kapacitet të instaluar prej 20 MW, operohet nga shoqëria “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. i pozicionuar në qarkun Korçë, ndërsa centrali tjetër me kapacitet të instaluar prej 30 MW, operohet nga shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. me vendndodhje në qarkun Fier. Të dyja shoqëritë ushtrojnë aktivitetin e shitjes së energjisë elektrike në treg të lirë me çmim të parregulluar.

Për të njëjtën periudhë korresponduese kanë vijuar të dalin në treg të lirë 2 hece me një kapacitet total të instaluar prej 6,4 MW, përkatësisht HEC-et “Faqekuq 1” dhe “Faqekuq 2” të cilët operohen nga shoqëria “HP OSTROVICA ENERGY” sh.p.k., që më herët ka zotëruar kontrata shit-blerje energjie me “FTL” sh.a.

Prodhimi neto i realizuar nga HEC-et e Kaskadës së Drinit gjatë muajit korrik arriti në 398,733 MWh, duke shënuar një rritje prodhimi prej rreth 93% krahasuar me energjinë elektrike të prodhuar në të njëjtin muaj të vitit të kaluar. Liqeni i Fierzës, i cili përbën rezervuarin kryesor të Kaskadës së Drinit, e nisi muajin me një nivel prej 293.05 m.m.n.d., ndërsa në fund të muajit niveli u regjistrua në kuotën 285.85 m.m.n.d. Sikurse evidentuar gjatë kësaj periudhe kemi ulje të nivelit në liqenin e Fierzës prej rreth 7.20 metër. Prurjet mesatare mujore rezultuan 51 m³/sek ndërsa rezerva energjetike për kaskadën e Drinit në fund të muajit korrik ishte 1020.1 GWh.

Përgjatë këtij muaji shoqëria publike “KESH” sh.a. nuk ka pasur shkarkime pa prodhim energjie nga portat e HEC-eve në kaskadë. Megjithatë, për shkak të pamjaftueshmërisë së prodhimit vendas për mbulimin e plotë të konsumit të energjisë elektrike në vend, shoqëria publike ka kryer procedura blerjeje energji elektrike në treg të parregulluar sipas detyrimit për shërbimin publik në sasinë 111.600 MWh me një çmim të mesatarizuar 125.47 Euro/MWh.

Balanca neto e shkëmbimit të energjisë elektrike për muajin korrik rezultoi 56,172 MWh (import), si diferencë e eksportit të realizuar në sasinë prej 221,877 MWh dhe importit të realizuar në sasinë 278,049 MWh.

Humbjet e përgjithshme të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike gjatë muajit korrik 2026 rezultuan në nivelin 14.91%, ndërsa humbjet në sistemin e transmetimit u regjistruan në vlerën 1.79%. Krahasuar me muajin qershor 2026, këta tregues paraqesin një rritje prej 0.37 % për sistemin e shpërndarjes dhe ulje prej 0.04 % për sistemin e transmetimit.

Në të gjitha tregjet e ALPEX-it gjatë muajit korrik u tregtuan gjithsej 236,082.36 MWh energji elektrike, ndërsa rrjedha ndërkufitare arriti në 80,679.65 MWh. Në Tregun e Ditës në Avancë u tregtua një volum total prej 226,279.55 MWh energji elektrike, me një çmim klerues mesatar prej 112.24 €/MWh, ndërsa në Tregun e Ankandëve Brenda të Njëjtës Ditë u tregtua gjithsej 9,802.81 MWh me një çmim mesatar ditor klerues prej 92.55 €/MWh. Numri i Anëtarëve të Bursës të cilët morën pjesë në Tregun e Ditës në Avancë ishte 48, ndërsa 34 prej tyre morën pjesë edhe në Tregun e Ankandëve Brenda të Njëjtës Ditë. Numri i Anëtarëve të Përgjithshëm të Klerimit arriti në 6.

BULETINI INFORMATIV

Vlerësimi i Raportit Vjetor të Pajtueshmërisë së ALBGAZ sh.a. për vitin 2025

Gjatë muajit gusht, Bordi i ERE shqyrtoi dhe miratoi analizën dhe vlerësimin e Raportit Vjetor të Pajtueshmërisë të shoqërisë “ALBGAZ” sh.a për vitin 2025.

Nga vlerësimi rezultoi përmirësim në strukturimin e raportimit, transparencën, ndarjen funksionale, dhe mbrojtjen e informacionit konfidencial. ERE rekomandoi vijimin e përmirësimit të monitorimit dhe dokumentimit të zbatimit të Programit të Përputhshmërisë, si dhe pasqyrimin e qartë të statusit të rekomandimeve të ERE-s në raportimet e ardhshme. Në veçanti, u vlerësua rëndësia e ruajtjes dhe dokumentimit të pavarësisë së operatorit në ushtrimin e funksioneve të tij, përfshirë ndarjen e përgjegjësi dhe marrëdhëniet me autoritetin



publik, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore.

Zbatimi i Programit të Pajtueshmërisë mbetet një element thelbësor edhe në kuadër të Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, pasi garanton pavarësinë funksionale të operatorëve, parandalon sjelljet diskriminuese dhe promovon transparencën e konkurrencën e ndershme në tregun e energjisë elektrike, në përputhje me kuadrin e ri ligjor dhe acquis të Bashkimit Evropian.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, në adresën www.ere.gov.al, në zërin Vendimet e Bordit, viti 2026 si dhe në Fletoren Zyrtare.

Vlerësimi i Reziliencës Kibernetike në Sektorin e Energjisë

Në kuadër të projektit rajonal “Cybersecurity for a Resilient Digital Future”, i cili zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP Shqipëri), me mbështetjen e Republikës së Sllovakisë dhe Qendrës Rajonale të UNDP-së në Stamboll, është ndërmarrë një nismë për vlerësimin e kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë (reziliencës) kibernetike në sektorin e energjisë në Shqipëri. Nisma synon të kontribuojë në identifikimin dhe vlerësimin e kapaciteteve ekzistuese, si dhe në evidentimin e fushave ku nevojitet forcimi i mëtejshëm i sigurisë dhe reziliencës kibernetike në sektorin e energjisë.

Në kuadër të këtij procesi, për lehtësimin e bashkëpunimit dhe realizimin e konsultimeve institucionale, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (MIE) i është kërkuar caktimi i pikave të kontaktit dhe strukturave përgjegjëse, nëpërmjet shkresës nr. 2212, datë 24.07.2026. Ky koordinim synon të mundësojë përfshirjen e institucioneve dhe strukturave përkatëse në procesin e vlerësimit dhe të sigurojë përcjelljen e informacionit të nevojshëm për realizimin e tij.

Në vijim të procesit të koordinimit ndërinstitutional dhe takimit të zhvilluar ndërmjet përfaqësuesve të ERE-së dhe ekspertës lokale të kontraktuar nga UNDP, Enti Rregullator i Energjisë përmbylli procesin e konsultimit dhe të mbledhjes së informacionit përkatës. Në këtë kuadër, më datë 21.08.2026, ERE përcolli pyetësin e intervistës të plotësuar, lidhur me kuadrin e kapaciteteve dhe reziliencës kibernetike në sektorin e energjisë (“Cybersecurity Capacity and Resilience Framework for the Energy Sector”).

Pjesëmarrja e ERE-së në këtë proces përbën një angazhim në kuadër të bashkëpunimit dhe koordinimit institucional për vlerësimin e kapaciteteve të sigurisë kibernetike në sektorin e energjisë dhe për identifikimin e nevojave të mëtejshme në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë dhe përballimit të rreziqeve kibernetike në sektor.

BULETINI INFORMATIV



Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit

Në mbledhjen e zhvilluar më datë 10.08.2026, Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 219, miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) për muajin korrik 2026, në nivelin 15.12 lekë/kWh për klientët e lidhur në tensionin 35 kV. Krahasuar me muajin qershor 2026, kur çmimi ishte 12.94 lekë/kWh, vlera e miratuar për korrikun rezulton 2.18 lekë/kWh më e lartë, duke shënuar një rritje mujore prej rreth 16.8%. Për klientët e lidhur në tensionin 35 kV, çmimi i FMF-së përcaktohet mbi baza mujore dhe reflekton dinamikën e kostos së blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës së klientëve që furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit në tregun e lirë. Në strukturën e këtij çmimi, tarifat e përdorimit të rrjetit dhe kostot administrative mbeten të pandryshuara, ndërsa komponenti që ndikon në luhatjen e tij është kostoja e energjisë së blerë.

Konkretisht, për muajin korrik 2026, çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike rezultoi 11.32 lekë/kWh, kundrejt 9.20 lekë/kWh në muajin qershor. Kjo përfaqëson një rritje prej rreth 23%, e cila është reflektuar edhe në çmimin përfundimtar të FMF-së, megjithëse në një masë më të moderuar për shkak të peshës së komponentëve të tjerë të pandryshueshëm në strukturën e çmimit. Për klientët e lidhur në tensionin 20/10/6 kV, të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit, çmimi i shitjes së energjisë elektrike mbetet i pandryshuar në nivelin 18.26 lekë/kWh, sipas vendimit të miratuar nga ERE në muajin shkurt 2026. Ky çmim mbetet fiks, pasi energjia për këtë kategori klientësh sigurohet nga KESH sh.a. me një kosto të qëndrueshme furnizimi. Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe për të garantuar transparencën ndaj palëve të interesuara, ERE miraton dhe publikon periodikisht çmimin e llogaritur të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, në zbatim të legjislacionit në fuqi

Furnizimi në tregun e lirë dhe ofertat e furnizuesve

ERE ka aktualisht të licencuara 41 subjekte në aktivitetin e furnizimit. Sipas të dhënave të raportuara nga të licencuarit, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga kushtet e licencës dhe nga Rregullorja për trajtimin e ankesave, rezulton se deri në fund të muajit gusht 10 furnizues janë aktivë në tregun e lirë, për konsumatorët e lidhur në nivelet e tensionit 6 kV, 10 kV, 20 kV dhe 35 kV.

Gjatë muajit gusht 2026, vetëm një furnizues ka raportuar raste ankesash të paraqitura nga konsumatorët e tij, ndërkohë që pjesa tjetër e furnizuesve nuk kanë raportuar ankesa për periudhën objekt raportimi. Ankesat e raportuara kanë qenë kryesisht të lidhura me faturimin e energjisë elektrike dhe ndryshimin e titullarit të kontratës.



BULETINI INFORMATIV

Ofertat e publikuara në Platformën e Krahimit të Çmimeve / Mjetin e Krahimit (PCT)

Gjatë muajit gusht 2026, 7 furnizues kanë qenë aktivë në Platformën e Krahimit të Çmimeve (PCT), duke publikuar oferta të ndryshme për furnizimin me energji elektrike, me çmime dhe periudha të ndryshme vlefshmërie, sipas niveleve të tensionit.

Sipas ofertave të publikuara në platformë, çmimet kanë rezultuar si më poshtë:



Niveli tensionit



Çmimi i energjisë

6 kv	16.90 – 18.34 Lekë/kWh
6 kv – stacione karikimi	22 Lekë/kWh
10 kv	15.80 – 18.34 Lekë/kWh
10 kv – stacione karikimi	22 Lekë/kWh
20 kv	22 Lekë/kWh
20 kv – stacione karikimi	22 Lekë/kWh
35 kv	15.20 – 15.90 Lekë/kWh

Publikimi i ofertave në PCT u mundëson konsumatorëve të informohen dhe të krahasojnë alternativat e furnizimit, duke mbështetur zgjedhjen e ofertës që i përshtatet më mirë nevojave të tyre.

Mbi analizën e Treguesve të cilësisë së vazhdueshmërisë së furnizimit me energji elektrike në rrjetin e shpërndarjes për 6-mujorin e parë të vitit 2026.

Gjatë muajit gusht 2026, ERE vijoi monitorimin e treguesve të cilësisë së shërbimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, duke vlerësuar ecurinë e tyre dhe duke i krahasuar me periudhat e mëparshme. Nga analiza rezultoi përmirësim i disa prej treguesve kryesorë të cilësisë së shërbimit, veçanërisht SAIDI dhe SAIFI, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, duke reflektuar reduktimin e kohëzgjatjes dhe frekuencës së ndërprerjeve të furnizimit dhe ndikimin pozitiv të konsumatori fundor. Gjithashtu, përqindja e klientëve të pajisur me matës arriti në 99.90%, duke dëshmuar një nivel shumë të lartë të mbulimit me matje. Ndërkohë, analiza evidentoi nevojën për vijimin e masave për përmirësimin e treguesve që lidhen me energjinë e pafurnizuar, cilësinë e tensionit dhe kohën e rikthimit të furnizimit pas defekteve, të cilët do të vijojnë të jenë në fokus të monitorimit të ERE-së. Në vijim, ERE do të vazhdojë bashkëpunimin me OSSH sh.a. për ndjekjen e masave të ndërmarra, identifikimin e faktorëve që ndikojnë në performancën e treguesve dhe forcimin e mëtejshëm të standardeve të cilësisë së shërbimit në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.



BULETINI INFORMATIV



01

Vendimmarrjet e Bordit të ERE-së gjatë muajit gusht

Gjatë muajit gusht 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) zhvilloi 5 mbledhje, për të cilat njoftimet përkatëse u publikuan paraprakisht në faqen zyrtare dhe në kanalet e komunikimit të ERE-së, në përputhje me parimet e transparencës dhe informimit të publikut duke u mundësuar të gjitha palëve të interesuara ndjekjen online të mbledhjeve. Gjatë këtyre mbledhjeve, Bordi miratoi gjithsej 30 vendime, të cilat trajtuan një gamë të gjerë çështjesh rregullatore, ndër to fillimin e procedurave të licencimit, dhënien, transferimin dhe modifikimin e licencave, miratimin e çmimeve dhe tarifave të rregulluara, si dhe akte të tjera rregullatore në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Për të garantuar informimin në kohë të publikut dhe transparencën e procesit vendimmarrës, pas çdo mbledhjeje u publikua një përmbledhje e vendimeve të miratuara në kanalet zyrtare të komunikimit të ERE-së. Ndërkohë, tekstet e plota të vendimeve janë të disponueshme në faqen zyrtare të institucionit, në rubrikën “Vendime”, si dhe publikohen në Fletoren Zyrtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Në kuadër të procedurave administrative dhe rregullatore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, gjatë muajit gusht 2026 u zhvillua seanca dëgjimore më datë 25.08.2026, lidhur me procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërive “HIDROINVEST” sh.p.k., OSSH sh.a. dhe “REI ENERGY” sh.p.k. Në seancë morën pjesë përfaqësuesit e shoqërisë “HIDROINVEST” sh.p.k. dhe OSSH sh.a., ku u paraqitën qëndrimet dhe argumentet e palëve lidhur me çështjen objekt shqyrtimi. Zhvillimi i kësaj seance është pjesë e procesit të shqyrtimit dhe trajtimit institucional të mosmarrëveshjeve në sektorin e energjisë, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Një ndër zhvillimet e rëndësishme të pasqyruara në komunikimin publik të ERE-së gjatë muajit gusht ishte miratimi i “Rregullave për regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar”, me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.08.2026. Në vijim të këtij vendimi, ERE vijoi informimin e operatorëve dhe palëve të interesuara mbi detyrimet për njoftimin dhe regjistrimin e impianteve të depozitimit të energjisë elektrike, në përputhje me kërkesat e kuadrit të ri ligjor. Gjithashtu, gjatë muajit gusht u vijua me publikimin e informacionit mbi zhvillimet në kuadër të bashkëpunimit dhe koordinimit rregullator në nivel rajonal. Në këtë drejtim, u publikua Raporti Vjetor 2025 i Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë (ECRB), i cili paraqet një pasqyrë të veprimtarisë dhe zhvillimeve të bashkëpunimit rregullator në kuadër të Komunitetit të Energjisë.



02

Publikime dhe përditësime në webfaqe dhe në rrjetet sociale

Gjatë muajit gusht 2026, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) vijoi komunikimin institucional dhe informimin e vazhdueshëm të publikut nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit dhe kanaleve zyrtare të komunikimit në rrjetet sociale. Publikimet dhe përditësimet e realizuara gjatë kësaj periudhe pasqyruan veprimtarinë vendimmarrëse, rregullatore dhe administrative të ERE-së, si dhe zhvillimet kryesore në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Në fokus të komunikimit institucional gjatë muajit gusht ishin vendimmarrjet e Bordit të ERE-së, njoftimet për mbledhjet e Bordit dhe çështjet e shqyrtuara, si dhe informacionet lidhur me procedurat administrative dhe rregullatore në sektorin e energjisë. Në këtë kuadër, në faqen zyrtare vijuan të publikohen njoftime dhe informacione mbi procedurat e licencimit, rinovimit dhe modifikimit të licencave, si dhe mbi aktet dhe masat rregullatore të miratuara gjatë muajit.

BULETINI INFORMATIV



Publikime dhe përditësime në webfaqe dhe në rrjetet sociale

Raporti ofron informacion mbi zhvillimet kryesore në fushën e rregullimit të tregjeve të energjisë dhe proceset e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve rregullatore të vendeve pjesëmarrëse.

Publikimi i këtij dokumenti kontribuon në rritjen e transparencës dhe në informimin e aktorëve të interesuar mbi progresin e proceseve rregullatore dhe zhvillimin e tregjeve energjetike në nivel rajonal. Në këtë kuadër, pjesëmarrja e ERE-së në strukturat dhe proceset e bashkëpunimit rajonal mbetet një element i rëndësishëm për shkëmbimin e eksperiencave, forcimin e koordinimit ndërinstitutional dhe përafrimin e mëtejshëm të praktikave rregullatore me standardet evropiane.

Gjatë kësaj periudhe, në faqen zyrtare të ERE-së vijuan të publikohen dhe përditësohen gjithashtu informacionet mbi proceset rregullatore dhe konsultimet publike, duke garantuar aksesin e palëve të interesuara në dokumentacionin përkatës dhe mundësinë e paraqitjes së komenteve dhe qëndrimeve të tyre. Publikimi në mënyrë periodike i këtyre materialeve synon të mbështesë një proces vendimmarrës transparent dhe gjithëpërfshirës.

Në webfaqen e ERE-së gjenden të përditësuara regjistrat elektronikë dhe informacioni institucional, përfshirë:

- * Kërkesa dhe përgjigje në Programin e Transparencës ([kliko këtu](#))
- * Ankesa të konsumatorëve ([kliko këtu](#))
- * Licencime ([kliko këtu](#))
- * Autorizime ([kliko këtu](#))
- * Procedurat e autorizimit në proces ([kliko këtu](#))
- * Procedurat e licencimit në proces ([kliko këtu](#))

ZHVILLIME RREGULLATORE

Gjatë muajit gusht 2026, ERE vijoi punën për zhvillimin dhe zbatimin e kuadrit rregullator, si dhe për shqyrtimin e çështjeve me rëndësi për funksionimin e sektorëve të rregulluar.

Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike", Bordi i ERE-s miratoi Rregullat për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike, të cilat përcaktojnë procedurën e regjistrimit të impianteve që përfshihen në regjimin kalimtar të parashikuar nga ligji.

Në sektorin e gazit natyror, ERE shqyrtoi Raportin e Pajtushmërisë së shoqërisë "ALBGAS" sh.a. për vitin 2025, në funksion të monitorimit të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Programi i Pajtushmërisë dhe kuadri rregullator përkatës.

Në fushën e rregullimit të çmimeve, Bordi përcaktoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) për muajin korrik 2026 në nivelin e tensionit 35 kV, në vlerën 15.12 lekë/kWh, ndërsa për klientët e lidhur në nivelet 20 kV, 10 kV dhe 6 kV vijoi të zbatohet çmimi 18.26 lekë/kWh.

Gjatë muajit vijuan gjithashtu proceset e konsultimit publik për projektaktet rregullatore, me qëllim përfshirjen e palëve të interesuara dhe marrjen e komenteve e propozimeve të tyre përpara miratimit përfundimtar të akteve.

Për më shumë informacion:

Ftojme të gjithë qytetarët, operatorët e tregut dhe palët e interesuara të vizitojnë faqen zyrtare të Entit Rregullator të Energjisë për të aksesuar vendimet e Bordit, aktet rregullatore, dokumentet në konsultim publik, raportet, tarifat dhe çmimet e energjisë elektrike, si dhe të gjitha publikimet më të fundit të institucionit.

Faqja zyrtare: www.ere.gov.al

Nëpërmjet kanaleve zyrtare të komunikimit në [Facebook](#), [Instagram](#) dhe [LinkedIn](#), ERE vijoi të përcjellë informacion mbi aktivitetin institucional, vendimmarrjet e Bordit, zhvillimet në sektorin e energjisë, proceset rregullatore dhe njoftimet me interes për konsumatorët, operatorët e tregut dhe palët e tjera të interesuara. Komunikimi në rrjetet sociale vijoi të shërbejë si një instrument plotësues për rritjen e aksesueshmërisë së informacionit dhe për informimin në kohë të publikut mbi veprimtarinë e institucionit.